

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,08.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të OE-ik "Rollemont" të datës 07.04.2021 të parashtruar lidhur me aktivitetin :Furnizimi me perde", me nr. të Prok: **616 21 856 121 nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "ROLLE MONT " e datës 07.04.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit" **Furnizimi me perde** kundër njoftimit për Vendimin e AK-se , të datës 02.04.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 02.04.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "ROLLEMONT " me datë 07.04.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me perde e Nr. të Prok: 616 21 856 121**

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet e parashtuesit të kërkesës për rishqyrtim lidhur me shperblimin e tenderuesit që nuk ka kryer furnizime të ngjajshme është i pa bazuar, sepse AK-ja ka kërkuar dëshmi për furnizime të ngjajshme e jo furnizime të njejtë, ndërsa edhe klasifikimi i procedurës është bërë në bazë të kësaj dhe ajo është klasifikuar me numrin 30000000-9 e që përfshin furnizimin me

paisje per zyre dhe makineri informatike. Poashtu tenderuesi i propozuar P ka te regjistruar veprimtarine per furnizim me paisje per zyre dhe ketu nuk mund te behet fjale se nuk eshte i regjistruar per keto furnizime.

Bazuar ne kete konstatoj se pretendimet jane te pa bazuara dhe kam vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit